

**VENDIM**  
**Nr. 730, datë 24.10.2012**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 545, DATË 16.8.2012 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE,**  
**BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE E TË STUDENTËVE NË**  
**INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2012 - 2013”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 25 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 1 e 5 të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 29 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 545, datë 16.8.2012 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 2.3 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Nxënësve të klasës së 13-të të shkollave profesionale, drejtimi “Termohidraulikë”, që nuk kanë përfituar bursë me vendim të këshillave të njëjësive të qeverisjes vendore, për periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale, mbështetur në kërkesën e drejtorisë arsimore rajonale u akordohet/miratohet bursë nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.”.

b) Në fund të pikës 12 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale për nxënësit e klasës së 13-të të shkollave profesionale, drejtimi “Termohidraulikë”, për vitin e ri akademik 2012 - 2013, të japë 456 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) muaj bursë. Analitikisht, numri i nxënësve, muaj/ditë bursë kuotë ushqimore, niveli/masa e bursës jepen sipas pasqyrës nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR/ZA-të, institucionet publike të arsimit profesional dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**